

## Ne fokus/ Nje stilist shqiptar i perzgjedhur nga Messi

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 21 Nentor 2013 18:16

---



Nje stilist shqiptar ka nisur te behet personazh. Muhamet Hasani eshte njeriu qe mendon te veshi lojtarin me te rendesishem ne te gjithë botën. Nuk behet fjale per nje futbollist te cfaredoshem por per Lionel Messin. Ylli argjentinas eshte nje ndjekes i rregullt i modes prandaj ai nuk deshiron te humbase asnje rast per te reklamuar imazhin e tij edhe jashte fushes. Stilisti shqiptar punon me mjaft pasion per te dhe Messi prej dy vitesh ka ndryshuar stil me duart e tij duke u bere me i hijshem ne te gjitha daljet publike. Gjate ceremonise per dorezimin e çmimit "Kepuca e Arte", Messi u shfaq me nje kostum te ri, sigurisht te stiluar vetem per te nga duart e shqiptarit qe punon prej vitesh per llogari te kompanise italiane "Ermenegild Zehna". Shume komplimenta mori pas saj per veshjen dhe performancen per te cilen ka merite te plote stilitisti shqiptar Hasani.